- **Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve**
- **Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**
- **Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit**
- **Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit**
- **Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit**
- **Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.**
- **Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.**
- **Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit**

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: [REF-99177-09-09-2026](#)

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **“Studimi i ndikimit të burimeve fotovoltaike në rrjet dhe automatizimi i procesit aplikim/miratim i pikës së lidhjes vetëprodhues/prodhues në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a”**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës: **“Studimi i ndikimit të burimeve fotovoltaike në rrjet dhe automatizimi i procesit aplikim/miratim i pikës së lidhjes vetëprodhues/prodhues në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a”**,
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor: **Drejtoria Rajonale Tiranë e OSSH sh.a**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për: **Studime inxhinierike 71335000-5** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: [REF-99177-09-09-2026](#)

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)
1.	Grumbullimi dhe verifikimi i të dhënave të rrjetit	1		
2.	Modelimi i rrjetit TM/TU në software teknik	1		
3.	Load-flow analysis	1		
4.	Short-circuit analysis	1		
5.	Voltage profil analysis	1		
6.	Hosting capacity study për FV	1		
7.	Analizë e humbjeve teknike	1		
8.	Analizë e ndikimit të FV në rrjetin TM/TU	1		
9.	Analizë e mbingarkesave në rrjet	1		
10.	Koordinim mbrojtjesh, sipas rastit	1		
11.	Rekomandime për masa teknike/përforcuese	1		
12.	Raport përfundimtar teknik dhe prezantimi i rezultateve	1		

13.	Të tjera, nëse ka	1		
	Çmimi total			_____
Çmimi Neto pa TVSH				
TVSH (%)				
Çmimi total me TVSH:				
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit				
Nënshkrimi				
Vula				
Datë _____				

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Objekti i kësaj kontrate është realizimi i një studimi të integruar tekniko-algoritmit për rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a. dhe automatizimin e procesit të aplikimit për pikën e lidhjes. Parametrat teknikë dhe kërkesat inxhinierike që duhet të plotësohen gjatë simulimeve dhe modelimit janë si më poshtë:

- **Modelimi i Rrjetit Elektrik:** Studimi duhet të bazohet në modelimin matematik dhe simuluar dinamik të flukseve të fuqisë (*Load Flow Analysis*), llogaritjen e rënieve të tensionit, humbjeve teknike dhe analizën e stabilitetit statik/dinamik në rrjetin e Tensionit të Mesëm (TM) dhe Tensionit të Ulët (TU).

- **Skenarët e Analizës:** Modelimi duhet të mbulojë skenarët e funksionimit të rrjetit në regjime kritike:
 - Gjenerim maksimal nga burimet fotovoltaike (PV) dhe hidrocentralet (HEC) i kombinuar me ngarkesë (konsum) minimale lokale.
 - Gjenerim minimal (ose zero) i impianteve PV i kombinuar me ngarkesë maksimale të rrjetit.
- **Standardet Inxhinierike të Detyrueshme:** Të gjitha analizat teknike, vlerësimet e harmonikave, cilësisë së energjisë dhe mbrojtjeve rele duhet të kryhen në përputhje strikte me Kodin e Shpërndarjes në fuqi, Rregulloren e Lidhjeve të Reja të miratuar nga ERE, si dhe standardet ndërkombëtare të inxhinierisë elektrike **IEEE, IEC** për cilësinë e energjisë dhe harmonikat, për llogaritjet e rrymave të lidhjes së shkurtër) **ose ekuivalente**.
- **Arkitektura e Automatizimit (Detyra 3):** Modeli i automatizuar i propozuar duhet të bazohet në një arkitekturë moderne softuerike (p.sh. *Service-Oriented Architecture - SOA* ose ekuivalent), duke dizajnuar flukset e punës (*workflows*) dhe ndërfaqet e programimit të aplikacioneve (*API*) që mundësojnë integrimin e ardhshëm me sistemet ekzistuese të OSSH sh.a. (*SCADA, GIS, Billing, ERP*).

Specifikimi i Materialeve:

Meqenëse objekti i prokurimit është shërbim konsulence, ky zë specifikon mjetet teknologjike, licencat softuerike dhe materialet/produktet intelektuale të dorëzueshme:

- **Softuerët e Analizës së Sistemeve Elektroenergjetike:** Kontraktuesi duhet të përdorë softuerë të specializuar, profesionalë dhe të njohur ndërkombëtarisht për analizën dhe simulimin e rrjeteve elektrike si: **DIgSILENT PowerFactory, PSS/E (Power System Simulator for Engineering), NEPLAN** ose ekuivalentë të tyre.
- **Softuerët e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS):** Për vizualizimin gjeografik të kapaciteteve absorbuese të rrjetit dhe integrimin e të dhënave të pikave të lidhjes, duhet të përdoren softuerë si **ArcGIS, QGIS** ose ekuivalentë.
- **Softuerët Statistikorë dhe Analitikë:** Për përpunimin e të dhënave të konsumit dhe gjenerimit historik, duhet të përdoren softuerë si **SPSS, R** ose ekuivalentë.
- **Formatet e Dorëzimit të Materialeve (Deliverables):**
 - Raportet narrative (Fillestar, të Ndërmjetme, Final) duhet të dorëzohen në format elektronik të editueshëm (Microsoft Word *.docx*), format jo të editueshëm (*.pdf*) dhe në kopje fizike të printuar.
 - Skedat e modelimit të rrjetit (modelet e simuluar të linjave, nënstacioneve dhe impianteve) duhet të dorëzohen në formatet amtare të softuerit të përdorur (p.sh. *.pfd, .sav* ose format ekuivalent sipas softuerit të përdorur), me qëllim që OSSH sh.a. t'i përdorë dhe t'i përditësojë ato në të ardhmen.

-
- Diagramat e fluksit të punës (*Workflows*) dhe specifikimet e platformës digjitale duhet të dorëzohen në formate standarde modelimi (si *BPMN 2.0*, *UML* ose ekuivalente).

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Zbatimi i shërbimit të konsulencës duhet të përmbushë kërkesat strikte operative dhe organizative të mëposhtme:

- **Grafiku dhe Afatet:** Shërbimi duhet të ekzekutohet plotësisht brenda afatit prej **9 (nëntë) muajsh** nga nënshkrimi i kontratës, duke respektuar me rigorozitet fazat e dorëzimit të raporteve (D-1, D-2, D-3, D-4) të përcaktuara në grafikun e ekzekutimit (Shtojca 7).
- **Validimi i të Dhënave:** Kontraktuesi është përgjegjës për mbledhjen, strukturimin dhe pastrimin e të dhënave teknike. Përpara përdorimit të çdo të dhëne në modelet e simulimit, kontraktuesi duhet t'ia prezantojë ato stafit teknik të OSSH sh.a. për verifikim dhe konfirmim zyrtar.
- **Pavarësia Logjistike:** Kontraktuesi do të kryejë shërbimin duke përdorur infrastrukturën e tij harduerike dhe zyrat e tij. Ai duhet të jetë i pajisur me stacione pune (kompjuterë) të aftë për të përballuar simulime të rënda elektroenergjetike dhe të ketë licenca softuerike të vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës.
- **Cilësia e Ekipit:** Shërbimi duhet të ekzekutohet nga ekipi i ekspertëve të miratuar në fazën e vlerësimit të ofertave. Çdo zëvendësim i mundshëm i ndonjë eksperti gjatë zbatimit të projektit mund të bëhet vetëm me miratimin paraprak me shkrim të OSSH sh.a. dhe eksperti i ri duhet të ketë kualifikime të barabarta ose më të larta se eksperti që zëvendësohet.
- **Mbrojtja e të Dhënave dhe Pronësia:** Kontraktuesi ka detyrimin të zbatojë rregullat e konfidencialitetit mbi të dhënat e rrjetit të shpërndarjes (të cilat përbëjnë infrastrukturë kritike kombëtare). Të gjitha modelet e rrjetit, skriptet e programuara dhe algoritmet e zhvilluara kalojnë automatikisht në pronësi ekskluzive të OSSH sh.a. pas dorëzimit përfundimtar.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Konsulencë për realizimin e studimit me titull: “Studimi i ndikimit të burimeve fotovoltaike në rrjet dhe automatizimi i procesit aplikim/miratim i pikës së lidhjes vetëprodhues/prodhues në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a”. Shërbimi përfshin analizën teknike të rrjetit në tension të mesëm (TM) dhe të ulët (TU), modelimin e flukseve të fuqisë, hartimin e metodologjisë së kapaciteteve absorbuese, si dhe propozimin e modelit të workflow-t dhe platformës së digjitalizuar për automatizimin e procesit të aplikim-miratimit të pikës së lidhjes.

Afatet e ekzekutimit:

Afati total për ekzekutimin dhe dorëzimin e shërbimit është 9 (nëntë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Grafiku i detajuar i ekzekutimit të shërbimeve dhe dorëzimit të raporteve (deliverables) sipas muajve paraqitet si më poshtë:

- **Dorëzimi i Raportit Fillestar (Inception Report - D-1):** Brenda **Muajit 1** nga nënshkrimi i kontratës *(Aprovimi nga stafi teknik i OSSH bëhet brenda gjysmës së parë të Muajit 2)*.
- **Dorëzimi i Raportit për Detyrën 1 (D-2):** Analiza e lidhjes në rrjetin e tensionit të mesëm të OSSH të centraleve fotovoltaike – Ekzekutohet gjatë **Muajve 2, 3 dhe 4** *(Aprovimi nga stafi teknik i OSSH bëhet brenda gjysmës së parë të Muajit 5)*.
- **Dorëzimi i Raportit për Detyrën 2 (D-3):** Ndikimi i lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes – Ekzekutohet gjatë **Muajve 5, 6 dhe 7** *(Aprovimi nga stafi teknik i OSSH bëhet brenda gjysmës së parë të Muajit 8)*.
- **Dorëzimi i Raportit Final për Detyrën 3 (D-4):** Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes – Ekzekutohet gjatë **Muajve 8 dhe 9** *(Aprovimi përfundimtar nga stafi teknik i OSSH bëhet brenda gjysmës së dytë të Muajit 9)*.

Skedulimi kohor dhe planifikimi për rezultatet e arritura

N	Raporti (Deliverables)	Muaji								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
D-1	Raporti Fillëstar (Inception Report)									
D-2	Detyra 1 : Analiza e lidhjes në rrjetin e tensionit të mesëm të OSSH të centraleve fotovoltaike									
D-3	Detyra 2: Ndikimi i lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes									
D-4	Detyra 3: Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit									

Legjenda:

- Implementimi i detyrës
- Koha e nevojshme për aprovim nga stafi teknik

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

“Studimi i ndikimit të burimeve fotovoltaike në rrjet dhe automatizimi i procesit aplikim/miratim i pikës së lidhjes vetëprodhues/prodhues në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a”

PËRMBAJTJA

Hyrje,

1. Objektivat e Studimit,

- 1.1. Vlerësimi i potencialit të integritetit të impianteve fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes.
- 1.2. Analiza e ndikimit Teknik të impianteve PV në rrjetin e shpërndarjes.
- 2.3, Identifikimi i kufizimeve dhe pengesave teknike dhe ekonomike.
- 2.4. Vlerësimi i ndikimit të impianteve fotovoltaike për vetëprodhim (deri në 500kW)
- 2.5. Përcaktimi i metodologjisë.
- 2.6. Propozimi i masave teknike dhe operacionale.
- 2.7. Analiza dhe optimizimi I procedurave të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes.
- 2.8. Propozimi i një modeli të automatizuar të procesit aplikim-miratim.

2. Fushëvëprimi i Studimit,

- 2.1. Detyra 1: Ndikimi i lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes.
- 2.2. Detyra 2: Ndikimi i lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes.
- 2.3. Detyra 3: Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit.

3. Organizimi I Studimit, koordinimi institucional dhe mbështetja logjistike,

- 3.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional.
- 3.2. Organizimi I punës dhe takimet teknike
- 3.3. Raporti Fillestar.
- 3.4. Raportimi dhe Komunikimi gjatë projektit 4.5. Mbështetja Logjistike dhe Burimet Teknike

4.6. Detyra të tjera organizative.

4. Kërkesat e Kualifikimit,

4.1. Kërkesat për përvojën e kontraktuesit.

4.2. Kërkesat për Kapacitetin Teknik dhe profesional

4.3. Kërkesa të tjera

5. Konfidencialiteti,

6. Buxheti,

Hyrje

Sektori elektro-energjetik shqiptar po kalon një fazë të rëndësishme tranzicioni, të orientuar drejt diversifikimit të burimeve të prodhimit, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike në përputhje me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, miratuar me vendimin nr. 480, datë 31.07.2018, ka përcaktuar si objektiv themelor garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të përballueshëm me energji elektrike, duke u mbështetur në integrimin rajonal dhe diversifikimin e sektorit energjetik.

Aktualisht, prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri mbështetet kryesisht tek hidroenergja, ku rreth 85% e fuqisë së instaluar gjeneruese në sistemin elektroenergjetik është nga hidrocentralet, të cilat kontribuojnë mesatarisht me rreth 90% të prodhimit vjetor. Megjithatë, kjo varësi e lartë nga kushtet hidrologjike krijon luhatje të konsiderueshme në prodhim nga një vit në tjetrin, veçanërisht në vite të thata, duke rritur ndjeshëm nevojën për importe dhe ekspozimin ndaj çmimeve të larta në tregun rajonal.

Në këtë kontekst, zhvillimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, veçanërisht nga energjia diellore, paraqitet si një zgjidhje strategjike për:

- reduktimin e varësisë nga importet;
- rritjen e sigurisë së furnizimit;
- diversifikimin energjetik;
- përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për reduktimin e emetimeve të CO₂.

Kuadri ligjor për nxitjen e këtyre burimeve është konsoliduar fillimisht me Ligjin Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i përafuar pjesërisht me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Europian. Në vijim, është Miratuar Rregullorja e Lidhjeve të Reja në


Sistemin e Shpërndarjes, me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me

Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016; Vendimin Nr. 234, datë 20.12.2019, Vendimin Nr. 133, datë


06.06.2022 të Bordit të ERE dhe Vendimin Nr. 145, date 19.07.2024. Më pas është miratuar edhe Udhëzimi Nr.3, datë 20.06.2019 “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, duke krijuar kushte më të favorshme për integrimin e impianteve me fuqi të vogla, veçanërisht të instaluar në catitë e subjekteve aplikuese (Buxhetorë, Jobuxhetorë,

Familjarë, dhe Privat). Zhvillimi i sektorit të energjisë fotovoltaike në Shqipëri ka marrë një ritëm të përshpejtuar vitet e fundit. Një moment kyç ishte viti 2019, kur nisën operimin impiantet e para gjeneruese fotovoltaike të lidhura në rrjetin 35 kV të sistemit të shpërndarjes, kryesisht të përqendruara në zonën bregdetare të qarkut Fier. Ky hap shënoi fillimin e integritimit më të strukturuar të energjisë diellore në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.


Aktualisht, në rrjetin e shpërndarjes rezultojnë gjithsej 236 burime gjeneruese me një fuqi totale të instaluar prej 516.349 MW. Nga këto, 51 impiante gjeneruese fotovoltaike (FV) me një fuqi të instaluar prej 136.716 MW, ndërsa pjesa më e madhe i përket hidrocentraleve (HEC), me 185 njësi dhe një fuqi të instaluar prej 379.633 MW. Këto të dhëna tregojnë se, ndonëse energjia hidrike vazhdon të zërë peshën kryesore në strukturën e prodhimit nga burimet e rinovueshme, sektori fotovoltaike po konsolidohet gradualisht dhe po rrit ndjeshëm praninë e tij në sistemin elektroenergjetik të vendit, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve dhe rritjen e sigurisë energjetike



Paralelisht, është zhvilluar ndjeshëm edhe segmenti i vetëprodhuesve (prosumers). Deri në fund të vitit 2025 rezultojnë të lidhur në rrjetin shpërndarës 3551 konsumatorë vetëprodhues me një fuqi totale të instaluar prej 286,25 MWp, ndërkohë që numri i aplikimeve është në trend rritës, sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm.



Ky zhvillim është në përputhje me vizionin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, e cila vendos konsumatorin në qendër të politikës energjetike dhe e inkurajon atë të marrë pjesë aktive në tranzicionin energjetik, duke përfituar nga teknologjitë e reja për uljen e kostove dhe kontrollin e faturës së energjisë.



Integrimi i këtyre burimeve në rrjetin e shpërndarjes ka transformuar rrjetin tradicional pasiv në një rrjet aktiv, ku prodhimi i decentralizuar krijon flukse të kundërta të fuqisë nga niveli i tensionit të ulët drejt niveleve më të larta (flukset nga TM në TL). Në shumë zona, ngarkesa lokale është relativisht e ulët dhe nuk mund të absorbojë plotësisht energjinë e gjeneruar nga impiantet PV, duke shkaktuar sfida teknike si:

- tejkalimi i kapaciteteve të linjave dhe transformatorëve;
- rritja e tensionit mbi kufijtë e lejuar;
- vështirësi në menaxhimin e balancës së sistemit,
- kufizime të mundshme të prodhimit.

Për më tepër, shumica e burimeve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes janë burime të pakontrollueshme për sa i përket fuqisë së gjeneruar (PV dhe HEC-e), çka e bën të domosdoshëm zhvillimin e infrastrukturës së rrjeteve inteligjente dhe sistemeve të monitorimit dhe automatizimit.

Në këtë kuadër, Neni 13 i Ligji Nr. 7/2017 përcakton detyrimin e operatorëve të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për zhvillimin e

infrastrukturës së rrjetit, rrjeteve inteligjente dhe sistemeve të depozitimit, me qëllim integrimin e sigurt dhe efikas të burimeve të rinovueshme, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për BREE.

Në këtë kontekst, OSSH sh.a. është duke ndërmarrë analiza teknike, ekonomike dhe ligjore për zhvillimin e rrjetit inteligjent dhe rritjen e kapaciteteve absorbuese të rrjetit të shpërndarjes.

Njëkohësisht, rritja e numrit të aplikimeve për lidhje në rrjet të impianteve PV dhe vetëprodhuesve është një sfidë për OSSH sh.a duke rritur ndjeshëm angazhimin e strukturave të saj për planifikimin e rrjetit të shpërndarjes ku injektohet energjia elektrike dhe kryerjen e regjimeve operationale dhe mirëmbajtjes së rrjetit shpërndarës, si dhe gjithashtu ka nxjerrë në pah nevojën për:

- standardizimin dhe digjitalizimin e procesit të aplikimit;
- reduktimin e kohës së shqyrtimit Teknik;
- rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së vendimmarrjes;
- integrimin e sistemeve të automatizuara të vlerësimit të kapaciteteve të rrjetit.

Bazuar në sa më sipër, ky studim ka për qëllim të analizojë në mënyrë të detajuar ndikimin teknik të burimeve fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes (nivelet e tensionit, flukset e fuqisë, humbjet, stabilitetin dhe sigurinë operationale), si dhe të propozojë një model të automatizuar për procesin e aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për vetëprodhuesit/prodhuesit në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a., në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar.

Ky dokument i termave të referencës përbën bazën konceptuale dhe institucionale për zhvillimin e një analize të integruar tekniko–ekonomike–rregullatore, e cila do të mbështesë vendimmarrjen strategjike për modernizimin e rrjetit dhe përshpejtimin e tranzicionit energjetik në Shqipëri.

Objektivat e studimit

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e integritit të burimeve fotovoltaike (PV) në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe të propozojë masa teknike, organizative dhe digjitale që mundësojnë integrimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të këtyre burimeve në rrjet.

Studimi synon gjithashtu të mbështesë automatizimin dhe përmirësimin e procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit në rrjetin e shpërndarjes.

Ky studim lidhet drejtpërdrejt me angazhimet e Shqipërisë për përmbushjen e objektivave të klimës dhe energjisë në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga “*Energy Community Treaty*” dhe harmonizimit me politikat e Bashkimit Evropian për energjinë e rinovueshme, në veçanti me “*Renewable Energy Directive*”. Në këtë kuadër, zgjerimi i prodhimit të energjisë nga burimet fotovoltaike përbën një element të rëndësishëm për rritjen e prodhimit vendas të energjisë, reduktimin e importeve, diversifikimin e burimeve të prodhimit dhe uljen e emetimeve të CO₂.

Në mënyrë më specifike, objektivat e studimit janë:

1. ***Vlerësimi i potencialit të integritetit të impianteve fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes***, duke analizuar kapacitetet ekzistuese të rrjetit dhe mundësitë për rritjen e prodhimit nga centralet PV të lidhura në rrjet;
2. ***Analiza e ndikimit teknik të impianteve PV në rrjetin e shpërndarjes***, përfshirë efektet në parametrat kryesorë të funksionimit të rrjetit si:
 - nivelet e tensionit;
 - humbjet teknike;
 - flukset e fuqisë;
 - stabilitetin dhe sigurinë e operimit të rrjetit.
3. ***Identifikimi i kufizimeve dhe pengesave teknike dhe ekonomike*** që ndikojnë në integrimin e mëtejshëm të burimeve fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe përcaktimi i masave dhe zgjidhjeve të mundshme për eliminimin e tyre;
4. ***Vlerësimi i ndikimit të impianteve fotovoltaike për vetëprodhim (deri në 500 kWp)*** të lidhura sipas skemës së matjes neto në rrjetet TM/TU, duke analizuar efektet e tyre në rrjetin e shpërndarjes dhe në parametrat e cilësisë së energjisë elektrike.
5. ***Përcaktimi i një metodologjie për vlerësimin e kapacitetit të pranueshëm të impianteve të vogla PV për vetëkonsum***, në funksion të karakteristikave teknike të rrjetit ku do të lidhen, me qëllim garantimin e funksionimit të sigurt dhe efikas të rrjetit.
6. ***Propozimi i masave teknike dhe operacionale*** për ruajtjen e parametrave të cilësisë së energjisë dhe sigurisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat për pajisjet mbrojtëse, rregullat e operimit dhe praktikatat e menaxhimit të rrjetit;
7. ***Analiza dhe optimizimi i procedurave të aplikimit dhe miratimit për pikën e lidhjes***, me fokus në identifikimin e hapave që mund të digjitalizohen dhe automatizohen për të rritur transparencën, efikasitetin dhe shpejtësinë e procesit për prodhuesit dhe vetëprodhuesit;
8. ***Propozimi i një modeli të automatizuar të procesit të aplikim–miratim të pikës së lidhjes***, i cili të mundësojë:
 - përpunimin e automatizuar të aplikimeve,
 - vlerësimin paraprak të kapacitetit të rrjetit për lidhje të reja,
 - reduktimin e kohës së shqyrtimit të kërkesave,
 - përmirësimin e koordinimit ndërmjet operatorit të rrjetit dhe aplikantëve.

Nëpërmjet realizimit të këtyre objektivave, studimi synon të krijojë një bazë teknike dhe metodologjike për integrimin e qëndrueshëm të energjisë fotovoltaike në rrjetin e shpërndarjes, duke kontribuar njëkohësisht në përmbushjen e objektivave kombëtare dhe evropiane për energjinë e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik.

Fushëveprimi i Studimit

Fushëveprimi i këtij studimi përfshin analizën teknike, operacionale dhe procedurale të integritetit të BREE në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri, me qëllim vlerësimin e ndikimit të tyre në funksionimin e rrjetit, identifikimin e kufizimeve teknike dhe operacionale, si dhe përcaktimin e masave për garantimin e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Një komponent i rëndësishëm i këtij studimi është gjithashtu analiza dhe përmirësimi i proceseve administrative dhe teknike që lidhen me aplikimin dhe miratimin e pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit e energjisë nga burimet fotovoltaike. Në këtë kuadër, studimi do të përfshijë edhe vlerësimin e mundësive për automatizimin dhe digjitalizimin e procesit të aplikim–miratimit të pikës së lidhjes, me qëllim rritjen e transparencës, efikasitetit dhe shpejtësisë së trajtimit të kërkesave nga ana e operatorit të rrjetit të shpërndarjes OSSH sh.a.

Në këtë kuadër, studimi do të zhvillohet në tre detyra kryesore.

Detyra 1: Analiza e lidhjes në rrjetin e tensionit të mesëm të OSSH të centraleve fotovoltaike

Kjo detyrë synon të analizojë ndikimin e centraleve fotovoltaike të lidhura në rrjetin e tensionit të mesëm të operatorit të shpërndarjes dhe të vlerësojë kapacitetin e rrjetit për të përthithur prodhimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe efikase.

Analiza do të përfshijë:

- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave teknike për centralet fotovoltaike të lidhura në rrjetin e tensionit të mesëm që janë aktualisht në operim, si dhe për ato të miratuara për lidhje, së bashku me të dhënat për rrjetin përkatës lidhës deri në kufijtë e lidhjes me rrjetin e transmetimit të OST sh.a;
- Modelimin dhe analizën e rrjetit, duke kryer llogaritjet e flukseve të fuqisë për skenarë të ndryshëm operimi, veçanërisht për regjimin e gjenerimit maksimal të centraleve PV. Në këtë kuadër do të analizohen:
 - profili i tensionit në nyjet kryesore të rrjetit;
 - humbjet teknike në rrjet;
 - nivelet e ngarkimit të linjave dhe transformatorëve.
- Vlerësimin e ndikimit të centraleve PV në performancën e rrjetit të tensionit të mesëm, duke analizuar efektet në humbjet e fuqisë, profilin e tensionit dhe kapacitetin e ngarkimit të elementeve të rrjetit;
- Identifikimin e nevojave për fuqizimin dhe modernizimin e rrjetit, për të mundësuar integrimin e mëtejshëm të centraleve fotovoltaike pa cënuar sigurinë dhe stabilitetin e sistemit;
- Propozimin e masave teknike dhe operacionale për ruajtjen e parametrave teknikë dhe të sigurisë së rrjetit, përfshirë kërkesat për pajisjet mbrojtëse, kontrollin e tensionit dhe koordinimin e operimit të centraleve;

- Koordinimin e zhvillimit të rrjetit ndërmjet operatorëve të sistemit, duke analizuar nevojën për planifikim të integruar të investimeve në rrjet ndërmjet OSSH sh.a. dhe OST sh.a., me qëllim absorbimin e plotë të gjenerimit nga burimet fotovoltaike;
- Hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit teknik dhe ligjor, përfshirë përditësimin e kërkesave në Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullores së Lidhjeve të Reja për burimet fotovoltaike që aplikojnë për t'u lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

Detyra 2: Ndikimi i lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes

Kjo detyrë fokusohet në analizën e ndikimit të impianteve fotovoltaike për vetëkonsum të lidhura në rrjetin e shpërndarjes dhe në përcaktimin e kapaciteteve të pranueshme për integrimin e tyre në rrjet. Detyra do të përfshijë:

- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave për impiantet fotovoltaike për vetëkonsum të lidhura ose të planifikuara për lidhje në rrjetin e shpërndarjes;
- Identifikimin e problematikave teknike që mund të krijohen në rrjetet e tensionit të mesëm dhe të ulët si pasojë e lidhjes së burimeve fotovoltaike për vetëkonsum, përfshirë:
 - devijimet e tensionit;
 - flukset e fuqisë;
 - ndikimin në humbjet teknike dhe në stabilitetin e rrjetit shpërndarës.
- Analizën e çështjeve të sigurisë, duke vlerësuar rreziqet potenciale për përdoruesit e rrjetit dhe për personelin e mirëmbajtjes së OSSH sh.a. që mund të lindin nga operimi i impianteve PV të lidhura në rrjet;
- Hartimin e një metodologjie për llogaritjen e kapacitetit të lejuar të impianteve PV për vetëkonsum në rrjetin e shpërndarjes, duke marrë në konsideratë parametrat teknikë të rrjetit dhe kufijtë e sigurisë së operimit;
- Vlerësimin e mundësive për rritjen e kapacitetit të injektimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike për autokonsum të klientëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të OSSH sh.a..
- Përgatitjen e rekomandimeve që lidhen me përmirësimin e kuadrit teknik dhe ligjor, përfshirë përditësimin e kërkesave në Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullores së Lidhjeve të Reja për burimet fotovoltaike për vetëkonsum, me qëllim garantimin e integritetit të sigurt dhe efikas të tyre në rrjet.

Detyra 3: Automatizimi dhe përmirësimi i procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit

Kjo detyrë synon analizimin dhe optimizimin e proceseve ekzistuese të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes për prodhuesit dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike, me fokus në digjitalizimin dhe automatizimin e tyre.

Detyra do të përfshijë:

- Analizën e procedurave aktuale të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes, duke identifikuar hapat administrative dhe teknike të procesit, kohëzgjatjen e tyre dhe strukturat e përfshira;

- Identifikimin e kufizimeve dhe pengesave në procesin aktual, të cilat mund të ndikojnë në kohën e trajtimit të aplikimeve, transparencën e procedurës dhe efikasitetin e përgjithshëm të procesit;
- Hartimin e një modeli të optimizuar të procesit të aplikimit dhe miratimit të pikës së lidhjes, i cili të standardizojë procedurat dhe të përmirësojë koordinimin ndërmjet strukturave teknike të operatorit të rrjetit;
- Propozimin e një platforme të digjitalizuar për menaxhimin e aplikimeve për lidhje në rrjet, e cila të mundësojë:
 - regjistrimin online të aplikimeve prodhues dhe vetëprodhues;
 - ngarkimin e dokumentacionit Teknik;
 - verifikimin paraprak të aplikimit;
 - ndjekjen në kohë reale të statusit të kërkesës.
- Integrimin e analizave teknike të rrjetit në procesin e vlerësimit të aplikimeve, duke propozuar mekanizma për vlerësimin paraprak të kapacitetit të rrjetit për lidhje të reja dhe për identifikimin automatik të kufizimeve teknike në zona të caktuara të rrjetit;
- Propozimin e indikatorëve të performancës dhe afateve standarde për trajtimin e aplikimeve, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe eficiencës së procesit;
- Rekomandime për integrimin e sistemit të automatizuar me sistemet ekzistuese të menaxhimit të rrjetit dhe të të dhënave teknike të operatorit të shpërndarjes OSSH sh.a..

Nëpërmjet kësaj detyre synohet krijimi i një procesi të standardizuar, transparent dhe të automatizuar për menaxhimin e kërkesave për lidhje të burimeve të rinovueshme në rrjetin e shpërndarjes, duke mbështetur njëkohësisht rritjen e depërimit të energjisë fotovoltaike dhe garantimin e operimit të sigurt dhe efikas të rrjetit elektrik.

Organizimi i studimit, koordinimi institucional dhe mbështetja logjistike

Për realizimin e këtij studimi, kontraktuesi do të bashkëpunojë ngushtë me operatorin e sistemit të shpërndarjes OSSH sh.a., i cili do të luajë një rol kyç në sigurimin e informacionit teknik dhe në mbështetjen institucionale të nevojshme për zhvillimin e analizave dhe përgatitjen e rezultateve të studimit.

Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional

Kontraktuesi do të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me strukturat përkatëse teknike të OSSH sh.a. për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për realizimin e studimit. Ky bashkëpunim do të përfshijë sigurimin e informacionit mbi:

- karakteristikat teknike të rrjetit të shpërndarjes në tension të mesëm dhe tension të ulët;
- të dhënat për centralet fotovoltaike të lidhura ose të miratuara për lidhje në rrjet;

- të dhënat për impiantet fotovoltaike për vetëkonsum;
- parametrat operativë dhe karakteristikat teknike të elementeve të rrjetit.

OSSH sh.a. do të mbështesë kontraktuesin gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe në sqarimin e aspekteve teknike që lidhen me funksionimin dhe planifikimin e rrjetit të shpërndarjes. Të dhënat e përpunuara dhe të formatuara nga kontraktuesi do t'i paraqiten operatorit të shpërndarjes për verifikim dhe konfirmim përfundimtar sipas grafikut të punës së miratuar përpara përdorimit të tyre në analizat e studimit.

Në kuadër të analizës së integritetit të burimeve fotovoltaike dhe ndikimit të tyre në sistemin elektroenergjetik, nëse është e nevojshme, OSSH sh.a mund të koordinohet gjithashtu me operatorin e sistemit të transmetimit OST sh.a. për çështje që lidhen me ndërfaqen ndërmjet rrjetit të transmetimit dhe atij të shpërndarjes.

Organizimi i punës dhe takimet teknike

Në fillim të projektit, kontraktuesi pritët të organizojë dhe të marrë pjesë në një takim fillestar (kickoff meeting) me përfaqësuesit e OSSH sh.a.. Qëllimi i këtij takimi do të jetë:

- prezantimi i objektivave dhe fushëveprimit të studimit;
- prezantimi i metodologjisë së punës dhe qasjes analitike;
- përcaktimi i pikave kryesore të projektit dhe planit të punës;
- identifikimi i burimeve të të dhënave dhe kanaleve të komunikimit ndërmjet palëve.
- Gjatë zhvillimit të studimit, kontraktuesi mund të organizojë dhe zhvillojë takime teknike periodike me stafin teknik të OSSH sh.a. me qëllim:
- mbledhjen e informacionit të nevojshëm teknik;
- diskutimin dhe verifikimin e parametrave teknikë dhe ekonomikë që do të përdoren në analizat e rrjetit;
- prezantimin dhe validimin e modeleve analitike të përdorura për studimin e rrjetit;
- shqyrtimin e rezultateve paraprake dhe të ndërmjetme të studimit.

Raporti Fillestar (Inception Report)

Ky raport do të shërbejë për të konfirmuar kuptimin e detyrës, metodologjinë që do të përdoret, planin e punës dhe të dhënat e nevojshme përpara se kontraktori të fillojë analizat e detajuara teknike.

Pjesë e këtij raporti, duhet të jetë dhe *Qasja metodologjike e studimit*, e cila duhet të përfshijë metodologjinë për secilën detyrë:

Metodologjia për analizën e lidhjes në rrjetin e tensionit të mesëm të OSSH të centraleve fotovoltaike dhe për ndikimin e lidhjes së konsumatorëve vetëprodhues në rrjetin e shpërndarjes:

- Analiza e profilit të tensionit: Vlerësimi i devijimeve nga kufijtë e pranueshëm të tensionit;
- Analiza e humbjeve të energjisë: Llogaritja e humbjeve të energjisë në linja dhe transformatorë;

- Analiza e cilësisë së energjisë: Vlerësimi i nivelit të harmonikave, fluksit dhe faktorit të fuqisë.
- Analiza e stabilitetit të tensionit: Vlerësimi i aftësisë së sistemit për të ruajtur tensionin brenda kufijve të pranueshëm në kushte të ndryshme të ngarkesës dhe prodhimit.

Metodologjia për automatizimin e procesit të aplikimit për lidhje:

- analiza e procesit aktual të aplikimit;
- hartimi i workflow të procesit;
- identifikimi i pikave për automatizim;
- konceptimi i platformës digjitale të aplikimit.

Raportimi dhe komunikimi gjatë projektit

Gjatë periudhës së realizimit të konsulencës, kontraktuesi do të përgatisë dhe paraqesë raporte të progresit, të cilat do të nisen nëpërmjet komunikimeve shkresore dhe elektronikisht stafit Teknik të OSSH sh.a. Këto raporte do të përshkruajnë:

- aktivitetet e realizuara gjatë periudhës përkatëse sipas grafikut të punës së miratuar;
- analizat e kryera dhe rezultatet paraprake;
- problematikat e hasura dhe mënyrat e adresimit të tyre.

Gjithashtu, kontraktuesi do të prezantojë rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të studimit, të cilat do të diskutohen me përfaqësuesit e OSSH sh.a. përpara finalizimit të raportit përfundimtar.

Mbështetja logjistike dhe burimet teknike

Gjatë zbatimit të projektit, kontraktuesi nuk do të ketë në dispozicion zyra të veçanta dhe as hapësira pune të dedikuara në ambientet e OSSH sh.a.. Për realizimin e aktiviteteve të studimit, kontraktuesi do të përdorë burimet dhe infrastrukturën e tij teknike.

Në këtë kuadër:

- Kontraktuesi do të përdorë harduerin dhe softuerin e tij për kryerjen e analizave të rrjetit elektrik, modelimin e sistemeve dhe përgatitjen e raporteve teknike;
- Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e mjeteve teknike dhe programeve të nevojshme për realizimin e analizave të flukseve të fuqisë, analizave të rënies së tensionit dhe vlerësimeve të performancës së rrjetit;
- Kontraktuesi do të mbulojë kostot e përkthimit dhe përpunimit gjuhësor të nevojshme për përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të studimit.

Detyra të tjera organizative

Në kuadër të realizimit të studimit, kontraktuesi do të jetë përgjegjës gjithashtu për:

- organizimin e aktiviteteve të brendshme të projektit dhe menaxhimin e ekipit të ekspertëve;
- koordinimin me palët e përfshira për sigurimin e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm;
- dokumentimin e analizave dhe metodologjive të përdorura në studim;

-
- sigurimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë së procesit të analizës dhe të rezultateve të studimit.

Nëpërmjet këtij organizimi të punës dhe koordinimit institucional synohet që studimi të realizohet në mënyrë efikase, duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet kontraktuesit dhe strukturave teknike të OSSH sh.a., si dhe duke garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e analizave dhe rekomandimeve të propozuara.

Kërkesat e Kualifikimit

Kontraktori do të përzgjidhet nga OSSH sh.a. në përputhje me legjislacionin shqiptar për prokurimin publik, në veçanti me kërkesat e përcaktuara në Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kontraktori i përzgjedhur duhet të jetë një firmë konsulence e kualifikuar ose një bashkim operatorësh ekonomikë (joint venture) që kanë demonstruar përvojë dhe njohuri të konsiderueshme në sektorin e energjisë elektrike, veçanërisht në fushat e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe në analizën e integritetit të burimeve të energjisë së rinovueshme në rrjetet elektrike.

Kërkesat për përvojën e kontraktuesit

Kontraktuesi duhet të dëshmojë përvojë të konsiderueshme profesionale në realizimin e studimeve dhe projekteve konsulence në sektorin e energjisë elektrike.

Në mënyrë të veçantë, kontraktuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar me sukses të paktën tre (3) kontrata konsulence të ngjashme gjatë pesë
(5) viteve të fundit, që lidhen me:
 - analizën e sistemeve të energjisë elektrike;
 - studime të integritetit të burimeve të energjisë së rinovueshme në rrjetet elektrike;
 - analiza të rrjeteve të transmetimit ose shpërndarjes;
 - studime për planifikimin dhe operimin e sistemeve elektroenergjetike.
- Kontraktuesi duhet të paraqesë një listë të projekteve të realizuara, duke përfshirë:
 - emrin e projektit;
 - institucionin ose kompaninë për të cilën është realizuar projekti;
 - përshkrimin e shkurtër të shërbimit të ofruar;
 - periudhën e realizimit;
 - vlerën e kontratës (nëse është e aplikueshme);
 - referenca nga klientët përkatës.

Firma duhet të demonstrojë përvojë në përdorimin e softuerëve të avancuar për analizën dhe modelimin e sistemeve elektroenergjetike, të përdorur në studime të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes.

Kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional

Kontraktuesi duhet të propozojë një ekip ekspertësh të kualifikuar që do të jetë përgjegjës për realizimin e të gjitha detyrave të përcaktuara në dokumentin e Termave të Referencës.

Stafi i tij duhet të ketë arsim të lartë universitar (minimumi diplomë master ose ekuivalente) në fusha të lidhura me:

- inxhinieri elektrike;
- sisteme elektroenergjetike;
- energji të rinovueshme;
- ekonominë dhe rregullimin e tregjeve të energjisë.

Ekspertët duhet të kenë përvojë të dokumentuar në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike;
- analiza dhe modeli i sistemeve elektroenergjetike;
- teknologjitë e energjisë së rinovueshme, veçanërisht centralet fotovoltaike;
- modeli dhe analiza e integritetit të burimeve fotovoltaike në rrjetin elektrik;
- planifikimi dhe operimi i rrjeteve të shpërndarjes dhe transmetimit;
- kuadri ligjor dhe rregullator në sektorin e energjisë elektrike.

Ekipi i projektit duhet të përfshijë, të paktën, ekspertët kryesorë të mëposhtëm:

- ***Inxhinierë të energjisë elektrike:*** Me specializim në sisteme të energjisë, analizë të rrjetit, dhe integrimin e energjive të rinovueshme. Ata do të jenë përgjegjës për modelimin e rrjetit, analizën e të dhënave dhe simulimet.
- ***Ekspertë në energji të rinovueshme:*** Me njohuri të thella në teknologjitë fotovoltaike, sistemet e ruajtjes së energjisë dhe politikat e energjisë së rinovueshme.
- ***Inxhinierë të softuerit:*** Për të zhvilluar mjete të specializuara për analizën e të dhënave dhe vizualizimin e rezultateve.
- ***Ekonomistë:*** Për të kryer analiza të kostove dhe përfitimeve dhe për të vlerësuar ndikimin ekonomik të investimeve në energji të rinovueshme.
- ***Specialistë në politikë energjetike:*** Për të analizuar politikat dhe rregulloret ekzistuese dhe për të rekomanduar ndryshime të mundshme

Kërkesa të tjera

Kontraktuesi duhet gjithashtu:

1. të ketë kapacitetin teknik dhe organizativ për realizimin e studimit brenda afateve të përcaktuara;

-
2. të disponojë mjetet dhe softuerët e nevojshëm për analizën dhe modelimin e sistemeve elektroenergjetike;
 3. të garantojë cilësinë dhe besueshmërinë e analizave dhe rekomandimeve të studimit;
 4. të respektojë standardet profesionale dhe teknike të zbatueshme në studimet e sistemeve elektroenergjetike.

Konfidencialiteti

